



osbe Organizata për Siguri dhe
Bashkëpunim në Evropë
Misioni në Kosovë



Fondacioni i Kosovës për Shoqëri të Hapur
Kosovo Foundation for Open Society
Kosovska Fondacija za Otvoreno Društvo



VOICE OF ROMA, ASHKALI
AND EGYPTIANS IN KOSOVO

Asociacioni i Gazetarëve të Kosovës shpall të hapur Konkursin për Çmimet Vjetore të Gazetarisë 2023

Asociacioni i Gazetarëve të Kosovës (AGK), në partneritet të ngushtë me Zyrën e Bashkimit Evropian në Kosovë, me mbështetjen e Fondit Evropian për Demokraci, Misionit në Kosovë të Organizatës për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë, Fondacionit të Kosovës për Shoqëri të Hapur, Zërit të Romëve, Ashkalive dhe Egjiptianëve, shpallë të hapur konkursin për Çmimet Vjetore për Gazetari.

Nëpërmjet këtyre çmimeve synojmë të nderojmë gazetarët që publikuan storje në vitin 2023, qoftë në mënyrë të pavarur, qoftë si punonjës të medimeve të ndryshme. Synimi ynë është të vlerësojmë raportimet mediatike për të inspiruar gazetarët që të vazhdojnë mbulimin e çështjeve të rëndësishme për audiencën.

Fitues të Çmimeve Vjetore të Gazetarisë do të jenë gazetarët dhe kameramanët/fotoreporterët, të cilët, pavarësisht rrethanave të vështira, prodhojnë lajme të cilat kanë ndikim të rëndësishëm në Kosovë.

Gazetarët nga e gjithë Kosova, pa marrë parasysh moshën, gjininë apo komunitetit të cilit i takojnë, ftohen të aplikojnë, storja e të cilëve është publikuar prej 1 janar 2023 deri më 19 nëntor 2023. Gazetarët duhet të nominohen nga redaksia e tyre ose mund të vetë-nominohen. Në të dyja rastet, në adresën elektronike të AGK-së duhet të dërgohet një letër që justifikon nominimin për gazetar të vitit së bashku me linqet e bashkangjitura të punës së gazetarit/es së nominuar.

Formën për aplikim mund ta shkarkoni [në këtë vegëz](#) dhe atë duhet ta dërgoni në adresën elektronike aplikimet@agk-ks.org deri më 4 dhjetor 2023.

Gazetarët kanë të drejtë të konkurrojnë me vetëm një storje apo cikël storjesh që trajton të njëjtën temë dhe vetëm në një kategori.

KATEGORITË E ÇMIMEVE:

1. Gazetari i vitit / Gazetarja e vitit

Ky çmim do t'i ndahet një gazetari/eje të përkushtuar drejtë standardeve më të larta të profesionit, i cili përmes raportimeve përgjatë vitit ka prodhuar lajme që kanë pasur një ndikim pozitiv në Kosovë dhe pavarësisht ambientit të rënduar të të bërit gazetari dhe rreziqeve personale, ka ofruar raportim me cilësi të lartë që edhe formon diskursin publik. Këtu hyjnë gazetarët që vëzhgojnë shpenzimin e parasë publike, shërbejnë si mbikëqyrës të ngjarjeve që formësojnë ndërveprimet midis ekonomisë, politikës, dhe sferave të tjera në Kosovë. Temat mund të jenë nga çdo sektor dhe vlerësohen në bazë të kriterëve të mëposhtme: stili dhe aftësitë e të shkruarit; vlera e shkrimit dhe ndikimi te shikuesit në përgjithësi; qasja unike; shkalla e vështirësisë dhe sfidat logjistike; raportimi i storjes; burimet dhe mjetet në dispozicion të përdorura në mbledhjen e informatave; ndikimi në shoqëri; efekti i arritur pas publikimit të storjes; dhe nxitja e diskutimit publik.

Çmimi shkon për gazetarin/en më aktiv/e i/e cila gjatë vitit 2023 është marrë vazhdimisht me publikimin e storjeve ekskluzive dhe që kanë nxitur debat në opinionin publik. Po ashtu element tejet i rëndësishëm është edhe efekti i arritur pas publikimit të storjes/storjeve.



Co-funded by
the European Union



Asociacioni i Gazetarëve të Kosovës
Association of Journalists of Kosovo



osbe Organizata për Siguri dhe
Bashkëpunim në Evropë
Misioni në Kosovë



Fondacioni i Kosovës për Shoqëri të Hapur
Kosovo Foundation for Open Society
Kosovska Fondacija za Otvoreno Društvo



VOICE OF ROMA, ASHKALI
AND EGYPTIANS IN KOSOVO

Gazetarët duhet të nominohen nga redaksia apo mund të vetnominohen. Në të dyja rastet, një letër që arsyeton nominimin për gazetar/e të vitit së bashku me vegëzat e bashkëlidhura të punës së gazetarit/es të nominuar, duhet të dërgohen në adresën elektronike të AGK-së.

Për këtë kategori kualifikohen:

- storjet televizive;
- Videostorjet e publikuara në mediat online;
- Storjet e shkruara në internet.

Shpërblimi: 1,000 EURO

2. TV Storja më e mirë e vitit

Në këtë kategori do të shpërblehet storja e cila ka pasur ndikimin më të madh gjatë vitit 2023. Temat mund të jenë nga cilido sektorë dhe vlerësohet në bazë të këtyre kriterëve: Stili dhe shkathtësia e shkrimit; Vlera e shkrimit dhe ndikimi tek shikuesit në përgjithësi; Qasja unike; Shkalla e vështirësisë dhe sfidat logjistike; mbulimi i storjes; Burimet në dispozicion dhe mjetet e përdorura në mbledhjen e informacionit; Ndikimi në shoqëri; Efekti i arritur pas publikimit të stories; Nxitja e diskutimit publik.

Në këtë kategori kualifikohen:

- vetëm storjet e publikuara në kanale televizive.

Shpërblimi: 700 EURO

3. Web Storja më e mirë e vitit

Storjet, qoftë videostorje apo të shkruara, të cilat janë të publikuara në uebfaqe dhe jo media tradicionale, janë qasje alternative e raportimit dhe ndikimi i tyre është gjithashtu i rëndësishëm duke marrë në konsideratë orientimin e gjeneratave të reja drejtë informacioneve të ofruara në platformat online. Për këtë arsye, me një çmim vjetor të gazetarisë do të vlerësohet edhe storja apo seritë e storjeve të përqendruara në një temë në bazë të rëndësisë së saj, mënyrës së trajtimit të çështjes dhe ndikimit që ka pasur.

Temat mund të jenë nga cilido sektorë dhe vlerësohet në bazë të këtyre kriterëve: Stili dhe shkathtësia e shkrimit; Vlera e shkrimit dhe ndikimi tek lexuesit / dëgjuesit në përgjithësi; Qasja unike; Shkalla e vështirësisë dhe sfidat logjistike; Gjithëpërfshirja e artikullit; Burimet në dispozicion dhe mjetet e përdorura në mbledhjen e informacionit; Ndikimi në shoqëri; Efekti i arritur pas publikimit të stories; Nxitja e diskutimit publik.

Në këtë kategori pranohen:

- videostorjet e publikuara në media online.
- storjet e shkruara të publikuara në media online.

Shpërblimi: 700 EURO



Co-funded by
the European Union



Asociacioni i Gazetarëve të Kosovës
Association of Journalists of Kosovo



osbe Organizata për Siguri dhe
Bashkëpunim në Evropë
Misioni në Kosovë



Fondacioni i Kosovës për Shoqëri të Hapur
Kosovo Foundation for Open Society
Kosovska Fondacija za Otvoreno Društvo



VOICE OF ROMA, ASHKALI
AND EGYPTIANS IN KOSOVO

4. Kameramani më i mirë i vitit / Kameramanja më i mirë e vitit

Roli i kameramanit/es kërkon aftësi të rëndësishme si përfshirja e pamjeve të përshtatura me kujdes dhe kreativiteti, aftësia për të zgjedhur lente të përshtatshme për kamerën si dhe aftësia për të komunikuar me gazetarin gjatë realizimit të një storje. Duke konsideruar këtë si një aspekt të rëndësishëm, AGK do t'i ndajë çmim një kameramani/e që ka demonstruar profesionalizëm në pamje kreative dhe mjeshtëri të kompozimit dhe ndriçimit. Temat mund të jenë nga çdo sektor dhe vlerësohen në bazë të kriterëve të mëposhtme: stili dhe aftësitë; vlera dhe ndikimi tek shikuesit në përgjithësi; qasje unike; shkalla e vështirësisë dhe sfidat logjistike; mbulimi i storjes; burimet dhe mjetet e disponueshme të përdorura në mbledhjen e informacionit; ndikimi në shoqëri; efekti i arritur pas publikimit të storjes; dhe nxitja e diskutimit publik.

Kameramani/ja duhet të përzgjedh një storje me pamjet më të mira që ka realizuar dhe formën e aplikimit ta dërgoj në adresën elektronike të AGK-së.

Në këtë kategori kualifikohen:

-Storjet e publikuara në TV apo media online.

Shpërblimi: 700 EURO

5. Çmimi i gazetarisë për fuqizimin e gruas

Ky çmim për qëllim ka nderimin e raportimit rreth rolit të grave në ndërtimin e paqes, jetën politike, avancimin e të drejtave të njeriut, zhvillimin ekonomik dhe social, me ç' rast synohet vetëdijesimi për rëndësinë e barazisë gjinore dhe fuqizimit të grave dhe pjesëmarrjen e tyre në proceset demokratike dhe zhvillimore.

Për përzgjedhjen e fituesve në këtë kategori, do të merren parasysh kriteret: Rëndësia e temës për fuqizimin e grave; Cilësia gazetareske përfshirë objektivitetin, analizën kritike, kuptimin dhe qasjen etike në trajtimin e temës; kreativiteti dhe stili, gjithëpërfshirja dhe respektimi i diversitetit si përpjekjet për të siguruar përfaqësimin e etnive, zërave dhe ideve të ndryshme në Kosovë.

Storjet në këtë kategori mund të jenë:

- TV storje;
- videostorje të publikuara në media online;
- web storje të shkruara.

Shpërblimi: 700 EURO



Co-funded by
the European Union



Asociacioni i Gazetarëve të Kosovës
Association of Journalists of Kosovo



6. Raportimi më i mirë nga sporti

Në këtë kategori e cila përfaqëson çmimin për gazetarët sportivë në Kosovë, do të shpërblehet një storje që demonstroi standardet më të larta të gazetarisë, por edhe shënon një përpjekje për të investuar në gazetarinë sportive, dhe për të mbrojtur integritetin e profesionit. Storjet vlerësohen në bazë të kriterëve të mëposhtme: stili dhe aftësitë e të shkruarit; vlera e shkrimit dhe ndikimi te shikuesit në përgjithësi; qasja unike; shkalla e vështirësisë dhe sfidat logjistike; mbulimi i storjes; burimet dhe mjetet e disponueshme të përdorura në mbledhjen e informacionit; ndikimi në shoqëri; efekti i arritur pas publikimit të storjes; dhe nxitja e diskutimit publik.

Storjet në këtë kategori mund të jenë:

- videostorje televizive;
- videostorje të publikuara në media online;
- web storje të shkruara.

Shpërblimi: 700 EURO

7. Raportimi më i mirë rreth anti-gjipsizmit

Kjo kategori përfaqëson një çmim të ri për gazetarët që raportojnë për anti-gjipsizëm, e cila është një lëvizje në Kosovë që lufton kundër racizmit dhe diskriminimit ndaj komuniteteve rom, egjiptian dhe ashkali. Lëvizja njihë rolin e rëndësishëm të mediave në formimin e opinionit publik dhe ndikimin në politikën. Me qëllim të nxitur raportimin e saktë dhe të balancuar në lidhje me eliminimin e diskriminimit racor ndaj këtyre komuniteteve, ky çmim njihë dhe promovon gazetarinë e balancuar dhe të detajuar në këtë fushë. Storjet vlerësohen në bazë të kriterëve të mëposhtme: stili dhe aftësitë e të shkruarit; vlera e shkrimit dhe ndikimi te shikuesit në përgjithësi; qasja unike; shkalla e vështirësisë dhe sfidat logjistike; mbulimi i storjes; burimet dhe mjetet e disponueshme të përdorura në mbledhjen e informacionit; ndikimi në shoqëri; efekti i arritur pas publikimit të storjes; dhe nxitja e diskutimit publik.

Storjet në këtë kategori mund të jenë:

- videostorje televizive;
- videostorje të publikuara në media online;
- web storje të shkruara.

Shpërblimi: 700 EURO

8. Raportimi më i mirë mbi shëndetësinë

Kjo kategori përfaqëson një çmim të ri ku gazetarët do të shpërblehen për raportimet më të mira në fushën e shëndetësisë, duke promovuar njohuritë dhe ndërgjegjësimin në lidhje me çështjet shëndetësore të rëndësishme. Ky çmim është një mundësi për gazetarët të ndajnë raportimet në përmirësimin e ndërgjegjësimit publik në lidhje me çështjet shëndetësore. Kjo kategori synon të nxisë raportim kualitativ në këtë fushë të rëndësishme për të përmirësuar kujdesin shëndetësor dhe shëndetin publik në përgjithësi. Storjet vlerësohen në bazë të kriterëve të mëposhtme: stili dhe aftësitë e të shkruarit; vlera e shkrimit dhe ndikimi te shikuesit në përgjithësi; qasja unike; shkalla e vështirësisë dhe sfidat logjistike; mbulimi i storjes; burimet dhe mjetet e disponueshme të përdorura në mbledhjen e informacionit; ndikimi në shoqëri; efekti i arritur pas publikimit të storjes; dhe nxitja e diskutimit publik.





osbe Organizata për Siguri dhe
Bashkëpunim në Evropë
Misioni në Kosovë



**VOICE OF ROMA, ASHKALI
AND EGYPTIANS IN KOSOVO**

Storjet në këtë kategori mund të jenë:

- videostorje televizive
- videostorje të publikuara në media online
- web storje të shkruara.

Shpërblimi: 700 EURO

VLERËSIMI

Vlerësimi dhe përzgjedhja e fituesve do të bëhet nga juria e përbërë nga shtatë anëtarë profesionistë. Procesi i përzgjedhjes do të bëhet me poentim nën masa konfidenciale dhe të transparencës etike, dhe do të mbikëqyret nga AGK-ja.

Anëtarët e jurisë do të jenë profesionistë që kanë njohuri të gjera mbi zhvillimet në Kosovë. Ata do t'i përzgjedhin raportimet fituese që i përmbushin më së miri kriteret, bazuar në kushtet e mësipërme të pranueshmërisë për secilën kategori të gazetarëve.

Fituesit do të shpallen në ceremoninë e ndarjes së çmimeve, që do të mbahet në Hotel Prishtina në Prishtinë më 12 dhjetor 2023.



Co-funded by
the European Union



AGK Asociacioni i Gazetarëve të Kosovës
Association of Journalists of Kosovo